



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 DHJETOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 15. DECEMBRA 2018. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Kërkesa e 42 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme për miratimin e Projekt-rezolutës mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

## **Dnevni red**

2. Zahtev 42 poslanika za vanrednu sednicu za usvajanje Nacrta-rezoluciju o procesu dijaloga za normalizaciju odnosa između Republike Kosova i Republike Srbije

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj që në sallë janë të pranishëm 61 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Para se të procedojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit ka vendosur t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë një deklaratë, përmes së cilës e dënon ndalimin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotit Slobodan Petroviq, nga Policia serbe dhe mbajtjes për disa orë duke e marrë në pyetje nga pjesëtarët e Shërbimit Sekret serb, gjatë kalimit të kufirit Kosovë-Serbi, më 8 dhjetor 2018.

Deklarata u është shpërndarë deputetëve, kërkohet vetëm deklarimi me votim për tekstin e deklaratës së propozuar, në qoftë se jemi gati, do ta kisha vërë në votim. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Janë vetëm 60 deputetë, gjersa në sallë janë 61 deputetë. A ka mundësi që dikujt nga kolegët deputetë nuk është duke i punuar elektronika, apo është e vërtetë që s'do dikush të votojë, ta dimë.

Nuk ke dëshiruar të votosh? Do të thotë, deklarata nuk kalon, a dëshironi ta vë edhe një herë në votim, apo jo? Nuk voton! Janë 61 deputetë, unë nuk kam arsye pse ta vë për faktin se deputeti në fjalë nuk dëshiron ta votojë. Nuk i ka 61 vota.

### **1. Kërkesa e 42 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme për miratimin e Projekt-rezolutës mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë**

Të nderuar deputetë,

42 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për miratimin e Projektrezolutës mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

E ftoj deputetin nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, zotin Visar Ymeri, që në emër të propozuesit ta paraqesë projektrezolutën.

VISAR YMERI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Kryeministër i Republikës së Kosovës,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Pas katër muajve të diskutimit e trajtimit të parimeve bazë të kornizimit të dialogut dhe procedurave të vendimmarrjes në të dhe për të, kemi arritur më në fund që këtij Kuvendi t'ia kthejmë rolin qendror në këtë proces shumë të ndjeshëm e të rëndësishëm për të tashmen e të ardhmen e Republikës së Kosovës. Me rezolutën që po e paraqesim sot, Kuvendi do të vendosë që:

- Ta themelojë delegacionin shtetëror, të bashkëkryesuar nga opozita dhe koalicioni qeveritar,
- T'i vendosë kornizat e platformës dialoguese shtetërore,
- T'i saktësojë përfitimet që Republika e Kosovës i synon nëpërmjet dialogut,
- T'i saktësojë dhe t'i sanksionojë me ligj procedurat vendimmarrëse në procesin e dialogut, duke ia bartur kompetencat vendimmarrëse delegacionit të mandatuar nga Kuvendi, si dhe marrëdhëniet që ky delegacion shtetëror do t'i ketë me institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës sa i përket procesit të dialogut, si dhe
- T'ia nënshtrojë marrëveshjen përfundimtare referendumit konsultativ, në të cilën qytetarët e Kosovës kolektivisht do të pyeten për pranueshmërinë e marrëveshjes.

Kjo fazë e dialogut, për shkak të kësaj mënyre të rregullimit që përcaktohet me këtë rezolutë, e që do të sanksionohet me Ligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror, është plotësisht e substancialisht e ndryshme me cilindo proces negociate, e me cilëndo fazë të deritashme të dialogut që e ka pasur Republika e Kosovës. Në të Republika e Kosovës për herë të parë po hyn me një përgatitje të duhur dhe me parime dhe synime të qarta. Procesi i dialogut do të jetë i pranueshëm vetëm nëse përfundimi i tij do të rezultojë:

- në njohje të ndërsjellë të shtetësisë nga palët e përfshira në proces,
- anëtarësim të Republikës së Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe
- zotim të verifikueshëm për përsheptimin e proceseve integruese të Republikës së Kosovës në Bashkim Evropian dhe në NATO.

Përbrenda këtij procesi të dialogut, delegacioni shtetëror obligohet të punojë sipas kësaj kornize, përmbajtjes dhe karakterit të dialogut, integritetit territorial dhe karakterit unitar të shtetit të Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sovraniteti shtetëror, integriteti territorial dhe karakteri unitar shtetëror i Republikës së Kosovës janë të pacenueshme dhe të patjetërsueshme.

Republika e Kosovës synon të zhvillojë dhe të mirëmbajë fqinjësi të mirë, të anëtarësohet në aleancën e NATO-s dhe në Bashkimin Evropian. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk do të përkrahë një proces të bisedimeve, i cili do ta kontestojë apo relativizojë këtë interes strategjik të shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk do të përkrahë një proces të bisedimeve, i cili nuk i përfill dhe i konteston këto fundamente strukturore dhe identitare të shtetit të Kosovës. Pra, që Republika e Kosovës është rregullim shtetëror i demokracisë parlamentare dhe i shoqërisë sekulare brenda traditës multikulturore.

Delegacioni shtetëror, i cili do të votohet sot, përbëhet nga 12 anëtarë, prej të cilëve 7 do të jenë nga koalicioni qeveritar, 4 nga opozita dhe një përfaqësues i shoqërisë civile. Kështu, brenda delegacionit shtetëror është krijuar vendimmarrje e barabartë mes pushtetit dhe opozitës dhe është krijuar hapësirë për përfshirjen e shoqërisë civile në vendimmarrje për sa i përket dialogut. Vendimet në delegacion do të jenë unanime dhe konsensuale. Në këtë proces dialogu, transparenca dhe llogaridhënia janë të sanksionuara me ligj. Kuvendi do ta themelojë një komision të veçantë, me përgjegjësi ekskluzive, për ta mbikëqyrur procesin e dialogut në secilën fazë të tij, për dallim prej herëve të kaluara, kur Kuvendi është përfshirë vetëm në fillim të procesit dhe është detyruar në fund ta ratifikojë marrëveshjen pa diskutuar asnjëherë, mënyrën e duhur, procesin dhe përmbajtjen e marrëveshjes.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kjo rezolutë i adreson të gjitha çështjet e ngritura deri tash në diskutimin publik e kuvendar për dialogun. Vendimmarrja në këtë proces është bartur te delegacioni shtetëror, i cili edhe mandatohet, edhe i jep llogari Kuvendit. Me rezolutë zotohemi e me platformën shtetërore do të konfirmohen pacenueshmëria dhe patjetërsueshmëria e sovranitetit shtetëror, e integritetit territorial dhe karakterit unitar të Republikës së Kosovës. Përmes këtij procesi të dialogut përfundimisht Serbia do të obligohet ta njohë Republikën e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Përndryshe, nuk do të ketë marrëveshje me Serbinë. Republika e Kosovës nuk do të zbatojë asgjë njëanshëm.

Faza e fundit do të jetë vërtet fundi i këtij lloj dialogu me Serbinë. Duke i pasur parasysh këto, unë nuk mund ta kuptoj asnjë kundërshtim karshi këtij rregullimi e pozicionimi të Republikës së Kosovës në dialog. Dhe, në të vërtetë, kundërshtime substanciale, konceptuale e parimore karshi tekstit të rezolutës ose tekstit të ligjit nuk kam parë e as dëgjuar deri tash. Që i bie që edhe kundërshtarët formalë pajtohen me tekstin që e rregullon dhe sanksionon procesin e dialogut. Por, nuk kam parë as ndonjë vërejtje serioze për kohën kur ndodh dialogu, që i bie kundërshtarët formalë pajtohen edhe me kontekstin e këtij dialogu.

Shfrytëzoj rastin edhe një herë t'i bëj thirrje edhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe Lëvizjes Vetëvendosje që të bëhen pjesë e delegacionit shtetëror dhe të marrin pjesë aktive e vendimmarrëse në këtë proces. Sjelljet e tyre që i kemi parë deri sot nuk janë kundërshtime

opozitare. Nuk mund ta kuptoj se si një subjekt opozitar e kundërshton hapësirën e vet vendimmarrëse brenda organit të vetëm vendimmarrës për dialogun që e themelon kjo rezolutë dhe që e rregullon ligji. Zakonisht opozita kundërshton kur nuk ka hapësirë vendimmarrëse dhe kur nuk ka transparencë të procesit. Këto të dyja i eliminon rezoluta. Ajo po ashtu vendos kritere e parime të qarta, të cilat janë folur e trajtuar disa herë nga opozita si domosdo për një proces të dobishëm dialogu. Në këtë proces do t'i kemi dy beteja: Njëra karshi mënyrës së deritashme të dialogimit, e trupëzuar në pushtetin aktual dhe tjetra, më e vështira, karshi Serbisë dhe tendencave të saj të pafundme hegjemoniste karshi tokave dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi.

Nuk kemi betejë me ata që kanë potencial dhe paraqesin fizionomi politike progresive. Ky lloj kundërshtimi që po dëgjohej sot, e që është dëgjuar dje, e që duket se do të dëgjohej edhe nesër, është i pabazë, i paqëndrueshëm, joparimor dhe mbi të gjitha jo i dobishëm për Republikën e Kosovës. Frika nga përfshirja, ikja nga përgjegjësia, përqendrimi kah rehatia personale e partiake karshi interesit të përgjithshëm e dëmtojnë Republikën e Kosovës, e dëmtojnë atë aktualisht e potencialisht. Prandaj është koha ta vendosim interesin e Republikës së Kosovës, interesin e përgjithshëm, përmbi e përtej tekeve, inateve, ambicieve e interesave personale.

Rrjedhimisht, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ju ftoj ta votoni sot këtë rezolutë dhe delegacionin shtetëror me këtë përbërje që do ta lexoj tash: Shpend Ahmeti nga Partia Socialdemokrate, Fatmir Limaj nga Nisma Socialdemokrate, si bashkëdrejtues të delegacionit shtetëror; Enver Hoxhaj nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar, Avni Arifi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar i delegacionit shtetëror, Behgjet Pacolli nga Aleanca Kosova e Re, anëtar i delegacionit shtetëror, Mahir Jagxhilar nga Grupi Parlamentar 6+, anëtar i delegacionit shtetëror, Dardan Gashi, zëvendëskryeministër, anëtar i delegacionit shtetëror, një përfaqësues i shoqërisë civile, emrin e përveçëm të të cilit do ta votojë delegacioni shtetëror, si dhe dy vendet e rezervuara për Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjen Vetëvendosje, e në të cilat do të mandatohen Visar Ymeri nga Partia Socialdemokrate dhe Dukagjin Gorani nga Partia Socialdemokrate derisa këto dy subjekte vendosin t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre.

Një përfaqësues shtesë do të jetë nga partitë politike të opozitës, si dhe një përfaqësues i komunitetit boshnjak. Pra, kjo është përbërja e delegacionit shtetëror me emra të përveçëm dhe me vendet e zbrazëta për ata emra të përveçëm, të cilët nuk i kemi sot, e që do t'i kemi ditëve në vijim.

Edhe një herë, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ju kërkoj e ju ftoj që ta votojmë këtë delegacion shtetëror dhe ta votojmë këtë rezolutë, në mënyrë që t'i hapim rrugë procesit dhe i cili parashih miratimin edhe të dy dokumenteve shumë të rëndësishme për dialogun, pra platformën shtetërore, si dhe Ligjin për përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi nga Partia Demokratike e Kosovës, në emër të Grupit Parlamentar.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Siç jemi dëshmitarë të gjithë, është e sata herë që me seancat qoftë të rregullta, qoftë të jashtëzakonshme po diskutojmë për dialogun, për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe sa herë që është diskutuar, pothuajse pa dallime partiake, është kërkuar që të arrihet një konsensus, një gjithëpërfshirje, një ekip apo delegacion përfaqësues që përfshin përfaqësues politikë nga pozita dhe nga opozita, por edhe nga shoqëria civile apo ekspertë të tjerë dhe pas kaq shumë diskutimesh, pas kaq shumë debatesh, ne sot kemi ardhur në një moment ku është arritur një konsensus, i cili ende nuk është krejtësisht gjithëpërfshirës, por që është një hap tepër i rëndësishëm për të vazhduar përpara me procesin e dialogut, i cili është një nga çështjet më urgjente apo prioritare me të cilat institucionet e Republikës dhe vetë shteti ynë duhet të merret në fazën e ardhshme.

Ajo që sot duhet të theksohet për sa i përket miratimit të kësaj rezolute është fakti që ne përmes saj besoj që po e përcaktojmë një qartësi në proces dhe për sa u përket roleve të delegacionit shtetëror, anëtarëve të tij, por po ashtu edhe të institucioneve kushtetuese, të cilët do të kenë përgjegjësi në procesin e dialogut. Mbi të gjitha, unë besoj që si pikë më e rëndësishme e saj duhet të shihet fakti që kodifikohet edhe përmes saj roli qendror i Kuvendit të Republikës së Kosovës, si institucioni që do ta ketë fillim e mbarim fjalën përfundimtare, meqenëse jemi të gjithë të vetëdijshëm që çfarëdo marrëveshje potenciale që mund të arrihet në fund të procesit, duhet të ratifikohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

E rëndësishme është që të gjithë kemi diskutuar për një platformë shtetërore, një platformë të përbashkët që përfaqëson edhe parimet themeltare, qëndrimet dhe pritjet apo objektivat e Kosovës në këtë proces, gjë që në një periudhë të shkurtër, siç parashihet edhe me rezolutë, brenda 30 ditësh do të vijë në Kuvendin e Republikës për të marrë mbështetjen e deputetëve, njëjtë sikur edhe projektligji që do të votohet më vonë. Më vjen keq që sot kemi mungesë të dy partive opozitare, sepse mungesa e tyre realisht është shmangie nga përgjegjësia shtetërore, të cilën unë konsideroj që në këtë proces e kemi edhe si pozitë, edhe si opozitë. Gjithsesi, mbesim me shpresë që në një moment jo të largët do t'i bashkohen këtij procesi, delegacionit shtetëror, meqenëse janë të paraparë që të kenë përfaqësuesit e tyre sikur edhe partitë e tjera politike.

Për sa i përket delegacionit, ne besojmë që përveç emrave, të cilët janë të përveçëm dhe që janë përfaqësues tashmë të ditur politikë, emrat, të cilët mbesin për t'u plotësuar, qoftë përfaqësuesi i shoqërisë civile, një përfaqësues i mëvonshëm i opozitës apo edhe përfaqësuesi i komunitetit boshnjak, duhet të miratohen përmes kalimit me procedurë parlamentare nga Kuvendi i Kosovës, meqenëse në këtë formë do të ishte mënyra më e mirë për t'i bërë të barasvlefshëm me pjesën

tjetër të ekipit dhe ky është qëndrimi ynë si Parti Demokratike e Kosovës, për çka besoj që pajtohemi të gjithë dhe nuk kemi pasur dallime kur e kemi diskutuar tekstin e projektrezolutës.

Po e përfundoj duke thënë që ne e mbështesim këtë projektrezolutë në tërësi dhe besojmë që është hap tepër i rëndësishëm për të vazhduar tutje me procesin, në të cilën përkundër shumë e shumë diskutimeve në muajt e fundit, kemi ngecur deri më tash. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Dukagjin Gorani, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.

**DUKAGJIN GORANI:** Kolegë të nderuar,

Sot po e bëjmë edhe një përpjekje që procesin e dialogut ta kthejmë nën kontroll dhe përgjegjësi të Kuvendit. Shpresoj t'i keni parë edhe ju, edhe opinioni publik dhe shpresoj t'i keni shfletuar projekt-dokumentet e hartuara nga PSD-ja, rezolutën dhe Projektligjin mbi dialogun.

Të dy këto dokumente janë të ndërlidhura mes veti. Rezoluta pa ligj nuk do të ketë fuqi detyruese, kurse ligji pa rezolutë nuk ka kontekst politik. Kjo është me rëndësi të theksohet, meqë vetëm miratimi dhe votimi i këtyre dy dokumenteve do ta mundësojë një proces transparent, ku vendimmarrja demokratike është kusht i funksionimit.

Me këto dy dokumente mundësohet baraspesha politike në këtë proces të ndjeshëm të bisedimeve, i cili për herë të parë pas shumë vjetësh do të bashkëdrejtohet mes pushtetit dhe opozitës aktuale.

Para së gjithash, kjo u mundësua nga raporti aktual i forcave politike në këtë Kuvend dhe kësaj nga të gjithë duhet të shihet si përmbledhje e mundësive, e jo si dëshmi e mangësive.

Tash e disa muaj Partia Socialdemokrate u angazhua që ta mendojë dhe ta ofrojë një formulë optimale dhe korrekte të përfaqësimit për të gjithë. Veç bashkëdrejtimit në delegacionit shtetëror, ku vendimet merren me 2/3 e votave, pesë vende janë të rezervuara për opozitën dhe për shoqërinë civile. Mbetem i bindur se një zgjidhje e tillë është pasqyrë reale e forcave në këtë Kuvend dhe e pamundëson dominimin dhe mbivotimin në proces nga ana e cilitdo përfaqësues, grup apo koalicion politik.

Prej themelimit e deri te mbikëqyrja dhe miratimi i veprimeve të delegacionit shtetëror, Kuvendi i Republikës mban rol qendror. Një zgjidhje e këtillë është me rëndësi tepër të madhe, marrë parasysh përvojën e deritashme shtatëvjeçare, kur bisedimet i zhvillonte pushteti i ditës në mënyrë të mbyllur, të paqartë, të privatizuar, e me këtë edhe të pazbatueshme.



Para së gjithash janë po këto përvoja traumatike të kombinuara sot me fuqinë e vogël aktuale që e ka ky koalicion qeverisës në këtë Kuvend, ato që e mundësojnë këtë raport të baraspeshuar të forcave politike në këtë proces. Mirëpo, pak ka rëndësi kjo punë sot, pak ka rëndësi qysh u arrit kjo, shumë më me rëndësi është që sot kjo të miratohet e të votohet, e me këtë të shndërrohet në realitet funksional, politik e shoqëror.

Kolegë të nderuar,

Procesi i dialogut me Serbinë nuk mund të jetë pronë e askujt, por është përgjegjësi e secilit prej nesh. Kjo çështje e mërzitshme që e ngrehim zvarrë me dekada përbën një pengesë të padinjitetshme, por besoj edhe të fundit në përpjekjen tonë për barazi në trajtimin ndërkombëtar për stabilitet rajonal dhe sovranitet shtetëror.

Besoj se sot është e qartë për të gjithë se suksesi i negociatave politike nuk varet vetëm nga mënyra se si janë zhvilluar ato, po shumë më tepër nga koha dhe çasti historik kur ato kanë përfunduar.

Qindra raste në historinë politike të botës dëshmojnë se bisedimet e vonuara, të tejzgjatura me dekada, rregullisht janë shndërruar në pjesën kryesore të problemit, në vend se të jenë zgjidhja e tij.

Republika e Kosovës, por edhe ajo e Serbisë janë vende tepër të vogla që ta mbijetojnë një konflikt të ngrirë politik për një kohë kaq të gjatë. Ky problem duhet të marrë fund për të mirën e të gjithëve. Tash e sa muaj kemi hyrë në periudhën e presioneve ndërkombëtare që kjo çështje e hapur tash e 20 vjet të përmbillet me sukses, që të arrihet një marrëveshje e qëndrueshme, ndërkombëtarisht e pranueshme dhe ligjërishme e obligueshme mes dy shteteve fqinje.

Për PSD-në, përmbyllja e vetme e suksesshme është e mbarështuar që në fillim të projektrezolutës së saj. Do të ruhet integriteti territorial dhe karakteri unitar i shtetit të Kosovës dhe do të mirëmbahen interesat strategjike të Republikës sonë.

Andaj, sot shpresojmë në pjesëmarrje nga të gjithë, meqë është përgjegjësi për të gjithë. Sot duhet ta bëjmë dallimin mes arsyeve për pjesëmarrje dhe arsytetimeve për mospjesëmarrje, dallimin mes ngritjeve partiake dhe obligimeve parlamentare, mes kritikës politike dhe ofendimeve personale. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tani fjalën e ka Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne qe disa muaj i kemi shqyrtuar këto dokumente dhe normalisht që në fund kemi arritur deri te një konsensus i përbashkët pozitë-opozitë dhe nuk ka nevojë për ndonjë elaborim më të gjatë, po përkundrazi, edhe rezolutën, edhe ekipin, i cili është propozuar, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Në emër të Nismës Socialdemokrate deklaroj këtu që japim mbështetje të plotë rezolutës dhe do të votojmë për. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar 6+, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë dhe kolege deputete,

Edhe ne si Grup Parlamentar 6+ i japim përkrahje dhe mbështetje kësaj projektrezolute dhe do të votojmë për të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha është e deputetëve pa grup parlamentar, në emër të tyre, Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Media,

Kor diplomatik,

Sot është një seancë e rëndësishme për Republikën e Kosovës, për mandatimin e delegacionit, i cili është i rëndësishëm, edhe pse është i vonuar, unë i kisha bërë thirrje edhe pjesës tjetër të opozitës që t'i bashkohet dhe ne të jemi të përfaqësuar sa më mirë. Natyrisht, AKR-ja e përkrah dhe ne do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi edhe tre deputetë, ju lutem! Milaim Zeka, në emër të vet, nga Nisma.

MILAIM ZEKA: Kryetar, hera e parë sot nuk dua të flas, kam vendosur të mos flas, kështu që e tërheq fjalën. Por, e mbështes rezolutën në mënyrë absolute.

KRYETARI: Faleminderit! Me aq sa shoh, nuk ka, a e kanë tërhequr edhe deputetë të tjerë fjalën. Jo, a? Emilija Rexhepi e ka fjalën. Bahrim, a e ke tërhequr fjalën?

EMILJIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Poštovani premijeru,

Predstavnicu Vlade,

Kolege poslanici,

I ako u prethodnom pregovaračkom timu koji nam je došao na glasanje u ovom Parlamentu nije bio predstavnik Bošnjaka, narod koji je ustavna kategorija, treći po broju stanovnika u Republici Kosova, posle Albanske i Srpske nacionalne zajednice, drago mi je što ste danas tu grešku ispravili i uvrstili slobodno mesto za predstavnik Bošnjaka, i dali nam prostora da izaberemo najbolju moguću osobu od ugleda i autoriteta u zajednici, koji će nas zastupati na najbolji mogući način, a ne kao do sada te smo imali negativnu iskustvu po pitanju decentralizacije, odnosno dobijanje opština u Peću kada nas je zastupao Sadik Idrizi, i od tih Bošnjačkih opština Rečane, Vitimirica i Gora do dan danas ništa nije urađeno.

Posebno želim da se zahvalim premijeru Vlade, predsedniku Skupštine, gospodinu Veseliju, ali i šefu Parlamentarne grupe PDK koji nas je upri stoji i dao nam prostora da pronademo najbolju moguću Bošnjačku osobu, a pre svega želim da se zahvalim i AAK grupi, koja nam je dala prostor da delujemo.

Još jednom predsedniče, u ovom Parlamentu, Bošnjački narod ne predstavlja samo deo Parlamentarne grupe 6+, ima u drugih Bošnjaka. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Rexhepi, gjithmonë aktive për komunitetin boshnjak. Zoti Bahrim, po ashtu fjala për ju!

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se predsedniče!

Poštovani premijeru,

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri, poslanici,

Ja iskoristiću priliku da ovom prilikom još jednom pozdravljam odluku da se ispoštuje naše traženje da u pregovaračkom ekipi uključuje jedan predstavnik Bošnjačke zajednice iz Republike Kosova. Naše učešće će samo doprineti konstruktivnom rešavanju ovom dijalogu sa Srbijom.

Zašto smo tražili premijeru, i oko ovaj bio je upoznat da smo konstantno tražili jednog predstavnika da imamo u tom timu, zato postoje opravdani razlozi.

Po meni postoji dva razloga, prvi razlog je da mi Bošnjaci kao integralni deo kosovskog društva smo druga zajednica, ne treća, po popisu iz 2011. godine.

I kao drugo, smatramo glavnim razlogom što na severu Kosova žive pripadnici naše zajednice Bošnjaci, što bi za njih bilo ohrabrujući da u ovim teškim vremenima kada se odlučuje po ovom važnom pitanju za državu i za naše građane Kosovare, Bošnjake severno od Ibra.

Ja još jednom zahvaljujem se Vladi i poslanicima parlamentarnim, pogotovo šefovima parlamentarnih grupa što su shvatili ozbiljno da i Bošnjaci trebaju imati svoje mesto u pregovaračkom timu. Ja se zahvalim!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Shabani! Deputeti i fundit është Danush Ademi, një deputet shumë aktiv.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë do ta votoj këtë projektrezolutë, edhe pse nuk jemi pjesë e delegacionit nga komuniteti hashkali, s'kemi përfaqësues, ne asnjëherë nuk jemi kundër, kemi besimin e plotë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, përfaqësuesit e së cilës janë votuar, edhe këta do t'i votojmë, asnjëherë nuk kemi qenë peng e diçkafit, ne si komunitet ashkali, gjithmonë do ta kenë besimin dhe mbështetjen tonë.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të paraqitur. Propozuesi, a e kërkon fjalën? Nuk ka nevojë. Kërkohet deklarimi me votim për tekstin e rezolutës së propozuar.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Janë 61 deputetë në sallë. Votojmë tash!

Me 61 vota, 59 për, dy abstenime, Kuvendi e miratoi rezolutën mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*